# DËSHMI ARKIVI

**A-448975**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zhgënjimi/ Gjykata Speciale dënoi Thaçin më shumë se Serbia, Haga i dha 25 vite, Millosheviçi e kishte dënuar me 10 vite në qeli |
| ADRESA | `https://tpz.al/zhgenjimi-gjykata-speciale-denoi-thacin-me-shume-se-serbia-haga-i-dha-25-vite-milloshevici-e-kishte-denuar-me-10-vite-ne-qeli-i333073` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 11:46:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:41:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7e3fa5ec8052e7be82a5700886d50d0db9f7f4c7a332fb1670285f9eb9ee37e0` |
| TEKSTI | `7b42a27f1fcae22896ec6b79feeef23f75a4208c0e5c742d07e6939aff137df7` |
| PAMJA | `a5f951831500a4772ed122f6e0d1c55454a590bcb44f40f394ae85d09ef76e45` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dacf3cc3d8998f73f5049a3b605ecf78b91132476bba890ddc0f07521025dc86` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dacf3cc3d8998f73f5049a3b605ecf78b91132476bba890ddc0f07521025dc86`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 16 SEPTEMBER 2026, 13:41

# Zhgënjimi/ Gjykata Speciale dënoi Thaçin më shumë se Serbia, Haga i dha 25 vite, Millosheviçi e kishte dënuar me 10 vite në qeli

TPZ



Gati tri dekada para dënimit me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë, Hashim Thaçi ishte dënuar në mungesë edhe nga sistemi gjyqësor i Serbisë.

Në korrik të vitit 1997, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, e cila në atë kohë funksiononte nën autoritetin e Beogradit, ia kishte shqiptuar Thaçit dënimin me 10 vjet burgim. Autoritetet serbe e akuzonin për veprimtari që i cilësonin terroriste dhe për sulme kundër policisë e ushtrisë serbe.

Procesi ishte zhvilluar në mungesë të tij, në një periudhë kur Serbia i ndiqte dhe i dënonte veprimtarët shqiptarë që angazhoheshin për çlirimin e Kosovës. Thaçi, i njohur gjatë luftës me nofkën "Gjarpri", vepronte ilegalisht dhe lëvizte ndërmjet Kosovës e vendeve të tjera, duke iu shmangur arrestimit nga forcat serbe.

Vendimi i vitit 1997 lidhej me veprimtarinë e tij në organizimin e rezistencës së armatosur dhe me sulmet që autoritetet e Beogradit ia atribuonin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Serbia e trajtonte UÇK-në si organizatë terroriste, ndërsa për shqiptarët e Kosovës ajo përfaqësonte lëvizjen çlirimtare kundër represionit dhe sundimit serb.

Thaçi nuk e vuajti dënimin e shqiptuar nga gjykata e kontrolluar prej autoriteteve serbe. Dy vjet më vonë, ai doli në skenën ndërkombëtare si drejtues politik i UÇK-së dhe udhëhoqi delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë.

Pas përfundimit të luftës, ai themeloi Partinë Demokratike të Kosovës, shërbeu si kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, ndërsa më vonë u zgjodh president. Në shkurt të vitit 2008, si kryeministër, Thaçi e lexoi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Në nëntor të vitit 2020, ai dha dorëheqje nga posti i presidentit pas konfirmimit të aktakuzës

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme "revolucioni" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

nga Dhomat e Specializuara dhe u transferua në Hagë.

imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Sot, më 16 shtator 2026, Trupi Gjykues e dënoi atë me 25 vjet burgim për krime lufte, duke e shpallur të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Kështu, Hashim Thaçi është përballur me dy dënime në dy periudha dhe rrethana krejtësisht të ndryshme: fillimisht nga sistemi gjyqësor i Serbisë së Sllobodan Milloshevičit në vite '90 për veprimtarinë e tij kundër pushtetit serb dhe, pothuajse 30 vjet më vonë, nga Dhomat e Specializuara në Hagë për pretendimet lidhur me krimet e kryera gjatë luftës. /Kosovapress



POTERNICA

Na osnovu čl. 551. i 554. Zakona o krivičnom postupku i naredbe Okružnog suda u Prištini K-37/97, Ministarstvo unutrašnjih poslova Republike Srbije - Sekretarijat unutrašnjih poslova u Prištini, zbog izdržavanja kazne zatvora od 10 godina, traga za teroristom:

HAŠIM TAČI zv. "Zmija"
od oca Hadžije, rođen 24.04.1968.godine u mestu Broćna, SO Srbijac

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:33

## Aktgjykimi ndaj liderëve të UÇK/ BE, apel për qetësi: Tregoni përmbajtje. Drejtësia duhet të lejohet të ndjekë rrjedhën e saj

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:18

## Ngërçi për pagat/ Disa gjykata veçojnë administratën nga gjyqtarët, zhbllokohet fondi për punonjësit

AKTUALITET / 16 September 2026, 13:11

## Reagimet/ 81 vite burg për çlirimtarët e Kosovës, nga Begaj te Albulena Haxhiu, të gjithë të zhgënjyer me vendimin e Hagës

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:48

## Kriza/ Rritja e ndjeshme e çmimit të karburanteve, ringrihet sërish Bordi i Transparencës

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:43

**VIDEO/ Vijojnë tensionet jashtë gjykatës speciale në Hagë, protestuesit e revoltuar sulmojnë policinë holandeze. Shoqërohen disa prej tyre**

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:38

**Operacioni/ Shiste kokainë dhe kanabis në lokalin ku punonte si kamerier, arrestohet 18-vjeçari në Elbasan**

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:28

**VIDEO/ Shpërthen tensioni jashtë gjykatës speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë. Shoqërohen disa prej tyre**

AKTUALITET / 16 September 2026, 12:04

**Shpallen të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, por liderët e UÇK-së dënohen nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg**

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:52

**Ish-krerët e UÇK-së dënohen rëndë nga "Specialja", reagon Rama: Marre!**

AKTUALITET / 16 September 2026, 11:01

**Trupi Gjykues i Gjykatës Speciale: Të paktën 303 persona u keqtrajtuan nga anëtarë të UÇK-së**

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:56

**Kryesuesi i Panelit të Trupit Gjykues në Hagë: Kjo çështje gjyqësore nuk ka të bëjë me legjitimitetin e UÇK-së, por**

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:54

**Gjyqi në Hagë/ Rrëzohen akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj popullatës civile për krerët e**

vetëm me përgjegjësi personale

UÇK-së

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:49

Credins bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!

Artikull Promocional

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:40

Detaje/ Prej tre ditësh i arratisur, autoritetet vijojnë kërkimet për shqiptarin Alket Rizain: Po kryejmë kontrolle në të gjithë Greqinë

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:26

"Ruani qetësinë"/ Haga nis leximin e vendimit ndaj krerëve të UÇK, gjyqtari hap seancën: Po gjykojmë përgjegjësi individuale, jo luftën çlirimtare

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:21

Konsultimet/ Rama mbërrin në Korçë për takimin mbi reformën territoriale, i pranishëm edhe djali i tij Greg Rama

AKTUALITET / 16 September 2026, 10:09

Pronat/ Banesat pa dokumente pronësie, Kadastra zbret në terren në 23 fshatra të Himarës, publikohet kalendari me datat e evidentimit derë më derë

AKTUALITET / 16 September 2026, 09:56

Operacioni/ U kap duke transportuar 6 emigrantë sudanezë drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Devoll




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.